



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:210967

Datë: 06.03.2023

Numri i dokumentit: 04048140

**C.nr.1020/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË**, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Feim Bytyqi, në çështjen juridike të paditësit Q. H. nga fshati B. Komuna e Suharekës të cilin me autorizim e përfaqëson Av.S. S. nga Suhareka kundër të paditurve J. G., F. G., N. G.,M. B.,S. B.,M. M. ,Sh. M. , B. K.,L. M.,A. G., A. G., A. B., dhe A. B. dhe H. G. nga B., me padi për vërtetimin e pronësisë në bazë të pohimit, në seancën kryesore të mbajtur në praninë të autorizuarit të paditësit av.S. S. dhe të autorizuarit të të paditurve J. G. , me dt.02.03.2023,mori ndërsa me datën 06.03.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Në bazë të pohimit**

**APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkespadija e paditësit Q. H. nga fshati B. Komuna e Suharekës.

**VËRTETOHET** se paditësi Q. H. nga fshati B. Komuna e Suharekës ka fituar të drejtën e pronësisë në parcelën kadastrale **P-72116003-.....-0** në sipërfaqe prej **859 m2** me kulturë tokë ndërtimore-oborr/tokë ndërtimore-shtëpi-ndërtesë/bujqësore-kullosë e klasës 4 në vendin e quajtur “F.” ZK B. ,Komuna e Suharekës e cila evidentohet në emër të të ndjerit Z. G. nga B..

Ky Aktgjykim do të shërbej si provë për regjistrimin e paluajtshmërisë në emër të paditësit si pronar në librat kadastral.

Shpenzimet e procedurës i bart secila palë të vetat.

**A r s y e t i m**

Paditësi Q. H. nga fshati B. Komuna e Suharekës, përmes të autorizuarës së tij Av.S. S. nga Suhareka kësaj Gjykate i ka parashtruar padi për vërtetimin e pronësisë mbi bazën e shitblerjes, ndaj të paditurit Z. (Z.) G. nga fshati B. Komuna e Suharekës.

Me parashtruesën e datës 20.09.2021 ka bërë ndryshim në aspektin subjektiv të padisë pasi që i padituri Zenun Guraziu ka vdekur dhe të paditur janë futur trashëgimtarët e tij J. G., F. G., N. G.,M. B.,S. B.,M. M. ,Sh. M. , B. K.,L. M.,A. G., A. G., A. B., dhe A. B. dhe H. G. nga B., nga B..

E autorizuara e paditësit Avokat S. S. në seancë gjyqësore ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe kërkesëpadija e ndryshuar, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se bazuar në

provat që u administruan në këtë çështje rezulton fakti se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që paditësit Q. H. nga fshati B. t'i vërtetohet e drejta e pronësisë në parcelën me nr. 0....-0 në vendin e quajtur "F." ZK B. në sipërfaqe 859 m<sup>2</sup>. Paditësi e ka në shfrytëzim faktik dhe me mirëbesim dhe pa ndërprerje mbi 20 vite parcelën e cekur më lart, e të cilin fakt ia kanë pohuar të gjithë trashëgimtarët ligjor të ish pronarit juridik. Andaj i ka propozuar gjykatës që ta miratojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit mbi bazën e shitblerjes e me anë të pohimit dhe paditësi të regjistrohet në librat kadastral si pronar juridik i ngastrës që është objekt i këtij kontesti. Shpenzimet gjyqësore nuk i ka kërkuar.

I padituri J. G. në seancë gjyqësore ka deklaruar se pajtohet në tërësi me deklaratimet e të autorizuarës së paditësit, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se flas në emër të të paditurëve të tjerë për të cilët kam edhe autorizimin dhe deklaroj se e pohoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit pasi që paditësi para më shumë se 20 vite e ka blerë këtë paluajtshmëri dhe qysh atëherë është futur në posedim aty ka ndërtuar shtëpinë dhe objektet përcjellëse dhe nuk kemi asnjë kontest në mes vete, fakti se kjo paluajtshmëri nuk është bartur tek paditësit ka qenë për shkak të pengesave të natyrës objektive pasi që nuk ka qenë e rregulluar çështja e trashëgimisë. Shpenzimet gjyqësore nuk i ka kërkuar.

Të paditurit A. B., A. B. dhe Sh. M. edhe personalisht në seancë e kanë pohuar kërkesëpadinë e paditësit por edhe përmes të autorizuarit J. G., ndërsa H. G. përmes deklaratës noteriale edhe ai e pohon kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata në kuptim të nenit 7 dhe 8 bëri shiqimin e provave dhe ate bëri shiqimin në: certifikatën e pronës me numër të lëndës 952-2/2016-.... për parcelën kadastrale P-72116003-0....-0 në sipërfaqe prej 859 m<sup>2</sup> me kulturë tokë ndërtimore-oborr/tokë ndërtimore-shtëpi-ndërtesë/bujqësore-kullosë e klasës 4 në vendin e quajtur "F." ZK B. Komuna e Suharekës, certifikatën 4271/22, ekspertizën e ekspertit gjeodet e dt.21.12.2022, deklaratat e dt.09.10.2009 e dhënë nga i padituri H. G. me nr.Vr.4471/09, autorizimin nr.LRP.4579/22, autorizimin nr.LRP.5293/22, autorizimin e dt. 22.04.2022 BRZI 413/22, autorizimin nr. LRP. 13248/22, aktvdekjën e dt. 16.06.2017, vërtetimin 02/04/11/2017, certifikatën e vdekjes V 10102360, certifikatat e vdekjes V 10102330, V 0132048, V 0133533, V 0102350, V 10102344, V10102392, certifikatat e gjendjes civile E 21047484, 21047505, E 21047487, E 21047469, E 21048445, E 21047778, E 21047436, E 21047447, certifikatat e lindjes L 21036713, E 21047407, E 21047415, E 21047437, E 21691060, E 21286482 dhe deklaratën nr. LRP 3921/2017.

Me ekspert gjeodet ka dalë në vend ngjarje për identifikimin dhe inqizimin e gjendjes në teren. Eksperti gjeodet H. D. ka konstatuar se palujtëshmeria e paditësit ka një disnivel për qka edhe është nderuar një mure mbrojtës përndryshe është një tërsi në të ka të ndërtuara objekte ndërtimore që i përkasin paditësit.

Gjykata pas leximit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, deklaratës së të autorizuarës së paditësit dhe deklaratës së të paditurit J. G. të dhëna në këtë procedurë, por edhe pas shikimit të vendit në vend u bind se në mes palëve nuk kishte asgjë kontestuese, paditësi e kishte blerë palujtëshmerin pra me shumë se 20 viteve, kishte paguar tere çmimin blerës dhe aty kishte të ndërtuar shtëpinë dhe objektet përcjellëse qysh atëherë me qka edhe me mbajtje me mirëbesim për më shumë se 20 vite në kuptim të nenit 40 par.1 të LPDTS me parashkrim e fiton pronësinë për qka gjykata vendosi që të aprovon në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Aktgjykimin Gjykata e muar ne kuptim të nenit 148 të LPK-së.

Gjykata hoqi dyshimet që kanë të bëjnë me kërkesat e palëve të cilët nuk mund të disponojnë lirisht neni 3.3 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u murr në kuptim të nenit të 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,  
C.nr.1020/2021 dt.06.03.2023**

**Bashk.profesion.  
Feim Bytyqi**

**Gjyqtari  
Robert Tunaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi palët e pakënaqura, kanë të drejtë ankese në afat prej 15 dite, pas marrjes së të njëjtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate.